

Fakulteti i Shkencave Mjekësore
Programi Studimor-Biomedicinë
Cikli i tretë i studimeve të Doktoraturës

UT - Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Përkohësisht Mbrojtësi i Veriut
VT - Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Përkohësisht Mbrojtësi i Veriut
Nr.-Bp. 22-366/1
20.02.2020 VIII/rod.
Tetovë - Тетово

Fakultetit të Shkencave Mjekësore
Këshillit Mësimor Shkencor të FSHM-së
Tetovë

Në bazë të Vendimit të datës 30.12.2019 për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Destan Haliti** të miratuar nga *Këshilli-Mësimor Shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës*, u formua Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Destan Haliti** në përbërje: Prof. Dr Kastriot Haxhirexha, Prof. Dr Nevzat Elezi, Prof. Dr.Lutfi Zylbeari, Prof.dr Sadi Bexheti, Prof. Dr Sheqibe Beadini Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës pas shqyrtimit të kërkesës të kandidatit **Destan Haliti** paraqet këtë:

Raport

për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Destan Haliti** me titull:
“Përcaktimi i laktat dehidrogjenazave, piruvat kinazave dhe acidit laktik tek pacientët me lëndime fizike të sistemit nervorë”

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatit **Destan Haliti** si në aspektin stukturor po ashtu edhe në aspektin përmbajtësor dhe hulumtues-shkencor i plotëson kriteret e një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Punimi i disertacionit të doktoraturës është i konceptuar në *Kapituj* dhe *Nënkapituj* dhe në kuadër të punimit janë përfshi: *100 faqe, 8 tabela, figura 42 dhe 22 grafikone.*

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatit **Destan Haliti** është i strukturuar për nga aspekti përmbajtësor dhe metodologjik në: *Hyrje, Materiali dhe metoda e punës, Qëllimi i punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, Summary dhe Literatura.*

I. HYRJA

Tek „**Hyrja**„ kandidati **Destan Halit** ka paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar tematika të problematikës së punimit të disertacionit të doktoraturës dhe ka cituar literaturë të shkëputur nga tematika e fushës përkatëse dhe të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Kandidati ka potencuar faktorë të riskut potencial të sëmundjeve kardiovaskulare dhe ka cituar fragmente të rëndësishme nga literatura vendase dhe botërore për të dhënë edhe një karakter më bindës punës hulumtuese të këtij disertacioni të doktorature.

Hulumtimet e fundit të mjekësisë, kujdesit intensiv dhe diagnostifikimet e fundit rreth lëndimeve të trurit rezultojnë në një zvogëlim të dukshëm të vdekjeve dhe aftësisë së kufizuar që rezultojnë nga dëmtimet e trurit.

Sidoqoftë ende nuk gjenden vlerësime të cilat do të vlerësojnë sasinë e proceseve fillestare destruktive dhe efekteve terapeutike për këtë arsye në dekadat e fundit hulumtuesit dhe klinikistët bazohen në markerët specifik qelizor të dëmtimeve të trurit për të dëshmuar diagnoza të dëmtimeve cerebrale. (Giacoppo S1, Bramanti P, Barresi M, Celi D, Foti Cuzzola V, Palella E, Marino S).

Disa proteina sintetizohen në qelizat e astroglieve ose në neurone siç është neuroni specifik enolaza, lidhja e kalciumit me proteinën B, proteina bazë e mielinës, izoenzimi i trurit keratin kinaza, acidi laktik, laktat dehidrogjenaza dhe piruvat kinaza, faktorët neutrofik dhe karboksi-hidrolaza terminale janë propozuar si marker potencial për qelizat e dëmtuara në sistemin nervor qëndror. Zakonisht niveli i këtyre proteinave tregon për rritjen e dëmtimeve të trurit dhe gjithashtu tregon për rritjen e koncentrimin të lëngut cerebrospinal në varësi të shkallës së

dëmtimit dhe gjithashtu mund të gjendjen në qarkullimin e gjakut për shkak të barrierës tru-gjak. Në këtë këndvështrim ne shqyrtojmë faktorët e ndryshëm që duhet të merren parasysh në kërkimin e biomarkerëve jo invaziv në lëndimet traumatike të trurit dhe rolin e tyre në vlerësimin e diagnozës dhe rezultateve.

II. QËLLIMI I PUNIMIT

Tek „ **Qëllimi i hulumtimit,** kandidati **Destan Haliti** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të qëllimit të punimit të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar qëllimin esencial të fushës shkencore hulumtuese të këtijë punimi. Sidomos fokusimi i qëllimit të punimit është mbështetur në problematikën e fushës së kirurgjisw dhe sidomos në fushën e sindromit metabolik dhe faktorwve tw rezikut potencial tw swmundjeve tw sistemit nervor qendror (SNQ). Me theks tw veçantw kandidati potencon preventivwn e swmundjeve tw SNQ dhe masat e duhura qw ndwrmwren pwr detektimin dhe zbulimin e hershw m tw kwtyre swmundjeve qw janw vdekjepruese pwr pacientwt.

Ky punim ka për qëllim të hulumtojë pacient të grupmohave të ndryshme para lëndimeve dhe pas lëndimeve fizike të sistemit nervorë.

Parametrat e analizuar siç janë:

- laktat dehidrogjenaza, piruvat kinazat, acidi laktik, glukoza dhe radikalet e lira do të mund të jenë tregues të mirëfillt për nivelin e dëmtimit të sistemit nervorë, apoptozat dhe nekrozat e qelizave të trurit.

Studimi jonë ka për qëllim të hulumtojë pacient të grupmohave të ndryshme para lëndimeve dhe pas lëndimeve fizike të sistemit nervorë. Rezultatet e hulumtimit tonë do të japin edhe një parametër shtesë për identifikimin e qelizave të lënduara të sistemit nervor pas lëndimeve fizike. Këto rezultate do të japin një kontribut të çmuar fushës së neurokirurgjisë dhe neurologjisë në veçanti dhe fushës së mjekësisë në përgjithësi.

Rezultatet e hulumtimit tonë do të tregojnë nivelin e dëmtimit të sistemit nervor pas lëndimeve fizike dhe pas rehabilitimit të pacientëve të hulumtuar.

Rezultatet e para të bëra në qendrën traumatologjike në Spitalin Klinik të Tetovës , korespondojnë me rezultatet e dhëna nga OBSH. Këto rezultate do të japin një pasqyrë reale

mbi gjendjen klinike të pacientëve të hulumtuar dhe do të kontribuojnë në diagnostifikimin e saktë të tyre.

III. METODA E HULUMTIMIT

Tek „ **Materiali dhe metoda hulumtuese,**„ kandidati **Destan Halit** paraqet në mënyrë të theksuar problematikën kryesore të metodologjisë hulumtuese të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar në mënyrë decide metodologjinë kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Kandidati ka përdorur metodologjinë më bashkëkohore për hulumtim duke u bazuar në metodat më të përsosura për hulumtim të mirëfilltë të kësaj problematike hulumtuese shkencore.

Materiali i analizuar është serumi i pacientëve kontrollë të analizuar dhe pacientëve me lëndime traumatike. Gjithsej do të analizohen 30 pacientë të moshave të ndryshme dhe 10 pacientë kontrollë.

Metoda e punës:

Analizat do të realizohen me metodën spektrofotometrike.

Materiali i gjakut për analizë laboratorike

Marja e gjakut kapilar

Gjaku kapilar fitohet duke shpuar mollzën e gishtit të tretë ose të katërt të dorës së majtë për arsye se këto gishta dhe dora e majtë pak përdoren në punë, përndryshe shpuarja mund të bëhet edhe në gishtat tjerë. Në fillim lëkura dezinfektohet me tampon vate me alkool ose eter dhe pastaj shpohet me lancet ose gjilpërë ku pika e parë fshihet me vatë të thatë e pika e dytë meret për analizë me kujdes duke mos e dëmtuar gishtin dhe elementet e gjakut. Rezultatet e fituara nga gjaku kapilar janë rreth 5 % më të ulta se ato të gjakut venoz.

Marja e gjakut venoz

Gjaku nga vena meret kur janë të nevojshme sasi më të mëdhaja gjaku për analiza laboratorike, biokimike dhe hormonale.

Gjaku meret më së shumti nga vena kubitale ose ndonjë venë tjetër të kapshme.

Në fillim krahu lidhet me esmarkun dhe pastaj dezinfektohet me vatën me alkool venae zgjedhur dhe shpohet me gjilpërën me epruvetën.

Mvarësisht se çfarë analizash kërkohen për serum, plazem ose elemente të gjakut dallojmë epruveta pa kuagulant (të thata) dhe me antikuagulant (EDTA, natrikum, cilikum, hepari, etj).

- Për serum na nevojiten epruveta të thata
- Për plazëm – epruveta me antikuagulant
- Për elemente të gjakut – epruveta me antikuagulant

Pas marjes së gjakut për serum epruveta centrifugohet në centrifugë –hitachi 6000 rrotullime në minutë kjo zgjat 5 - 10 minuta. Ndërsa për plazëm dhe elemente të gjakut gjegjësisht me antikuagulant duhet të përzihet me kujdes prej njëres anë në tjetrën, për arsye që mos të prishen elementet e gjakut të hemolizohen.

IV. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Tek „ **Rezultatet,**” kandidati **Destan Haliti** ka paraqitur dhe ka ilustruar në mënyrë tabelarësh, grafikonesh dhe figurave problematikën kryesore të fushës së ngushtë të kësajë lëmijë shkencore hulumtuese. Rezultatet e fituara i ka shprehur në formë të ilustrimeve të qartësuara me vlera referente dhe vlera të fituar të cilat shprehin vlera determinante për diagnostifikimi e hershëm dhe të saktë të kësajë problematike.

Rezultatet e paraqitura nëpërmjet tabelave, grafikoneve dhe figurave janë të përpunuara me anë të metodologjisë më të sofistikuar *p value* dhe vlerave referente botërore. Këto rezultate do të japin një kontribut të çmuar për diagnostifikimin e sëmundjeve që janë të lidhura me sindromin metabolik dhe sidomos tek sëmundjet kardiovaskulare. Rezultatete fituara do ti shërbejnë fushës së mjekësisë në përgjithësi dhe fushës së kardiologjisë në veçanti.

Tek diskutimi kandidatja ka paraqitur në mënyrë shumë të detajuar problematikën e fushës hulumtuese dhe ka bërë krahasimin e rezultateve me shumë autor të vendit dhe sidomos me theks

të veçantë potencojme krahasimin e vlerave të kandidatëve me vlerat referencë të shumë autorëve botërorë që merren me problematikën kësaj fushe hulumtuese.

IV. PËRFUNDIMI

„Përfundimi,“ kandidati **Destan Haliti** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore dhe përfundimtare të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke dhënë rekomandimet përfundimtare dhe finale të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Rezultatet e fituara nga kandidati gjithashtu i ka shprehur me ilustrime shumë decide për të sjellur konkludimet e duhura dhe të mirëfillëta për këtë fushë hulumtuese shkencore.

Diagnoza dhe vlerësimet e dëmtimeve të trurit bazohen në ekzaminimet klinike dhe teknikave të sofistikuara (moderne) – siç janë neuro teknikat. Elektrofiziologjia, monitorimi hemodinamik dhe neuromonitoringu invaziv përbëjnë mjete shtesë për monitorimin e funksionit të trurit dhe kushtet klinike të pacientit.

Sidoqoftë përkundër progresit substancial, metodat klinike dhe neuro monitoruese shpesh nuk janë të mjaftueshme për të vlerësuar sasinë e proceseve degraduese fillestare dhe dytësore dhe kështu ato nuk mund të udhëzojnë masa efektive terapeutike për të parashikuar efektivisht rezultatin.

Gjatë dhjetë viteve të fundit hulumtuesit dhe klinikistët janë fokusuar në dëmtimet specifike të qelizave të trurit për të përmirësuar diagnozën dhe monitorimin e dëmtimeve neurologjike.

Laktat dehidrogjenaza, kreatin kinaza, enolazat janë propozuar si shënues të mundshëm të lëndimeve të trurit. Kohët e fundit marker të tjerë glial janë proteina bazë e mielinës, proteina acid fibrilare gliale dhe proteina B, të cilat janë matur në gjak dhe përdoren si shënues marker biokimik për dëmtimet e trurit.

V. BIBLIOGRAFIA

Tek „**Bibliografia**„ kandidati **Destan Haliti** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke përshkruar dhe cituar literaturë përkatëse të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Tek ky punim doktore do të fokusohet në literaturën më standarde dhe më bashkëkohore, në mënyrë të drejtë do të citohen referencat e punimit të doktoraturës. Këto referenca të cituara do ta plotësojnë dhe do ti japin një karakter edhe më përmbajtësorë punimit të doktoraturës sepse do tu përkasin referencave më bashkëkohore të cituara me impakt ndërkombëtar, prandaj shiqar edhe nga ky aspekt ky punim do ti plotëson të gjitha standardet bashkëkohore të një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.


Dukë u bazuar në të dhënat punimit të disertacionit të doktoraturës, konsiderojmë se ky punim i doktoraturës do të sjellë një risi në fushën e neurokirurgjisë sidomos në përcaktimin e laktat dehidrogjenazave, piruvat kinazave dhe acidit laktik tek pacientët me lëndime fizike të sistemit nervor në përgjithësi.

Ky punim në veçanti do të kontriboj në fushën e neurologjisë dhe mjekësisë, prandaj kërkojë nga **Këshilli Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore**, që ta miratojë punimin e disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Destan Haliti** me titull: **“Përcaktimi i laktat dehidrogjenazave, piruvat kinazave dhe acidit laktik tek pacientët me lëndime fizike të sistemit nervorë”**


Tetovë më, 30.01. 2020

Anëtarët e komisionit:


Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha



Prof. Dr. Nevzat Elezi



Prof. Dr. Lutfi Zylbeari



Prof. Dr. Sadi Bexheti



Prof. Dr. Sheqibe Beadini

